



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 325/22

Paneli Shqyrtues, i Organit Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani – Kryetare, paneliste individuale, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) N.T.SH.M "Letamed" SH.P.K, Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Karrige Stomatologjike" me nr. prokurimit 623-22-4578-1-2-1, iniciuar nga Kouma e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 20.09.2022, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar, ankesa e OE N.T.SH.M "Letamed" SH.P.K. në Suharekë, e datës 09.08.2022, regjistruar me (Nr. Protokolli 325/22), kurse njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Karrige Stomatologjike" me nr. prokurimit 623-22-4578-1-2-1, iniciuar nga Kouma e Rahovecit në cilësinë e AK Vertetohet.
- II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit, sepse mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që sipas nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar) të ndërmarr masa ndaj AK.
- III. Meqë ankesa e OE N.T.SH.M "Letamed" SH.P.K. në Suharekë është refuzuar si e pa bazuar, bëhet konfiskimi i mjeteve të depozituara për ankesë dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.06.2022, Kouma e Rahovecit në cilësinë e AK e ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Karrige Stomatologjike” me nr. prokurimit: 623-22-4578-1-2-1, kurse me 02.08.2022, po ky AK ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit të cituar si më parë.

Me 06.08.2022, OE N.T.SH.M “Letamed” SH.P.K. në Suharekë, ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtimin e Vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar nga AK me vendim e datës 08.08.2022. Për këtë arsye, me 08.08.2022, OE N.T.SH.M “Letamed” SH.P.K. në Suharekë, ka ka parashtruar ankesë në OSHP (Nr. Protokolli 325/22), kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit që në pajtim me nenin 113 të LPP, që ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 26.08.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që

- Ankesa e OE të refuzohet si e pa bazuar;
- Aktiviteti i prokurimit me numër dhe datë të specifikuar më lartë të mbëtët në fuqi;

Raporti i vlerësimit është pranuar nga të dyja palët me ç’rast Ankuesi (N.T.SH.M “Letamed” SH.P.K. në Suharekë) nuk është pajtuar plotësisht me raportin e cituar si më sipër, përderisa AK me datën 12.08.2022 ka shprehur pajtueshmëri me mendimin e ekspertit.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues analizoi shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët (OE dhe AK) pohimet e Ankuesit dhe shqyrtimin paraprak të ekspertit dhe duke i krahasuar të gjitha ato, konsideron se Raporti i cituar si më sipër i Ekspertit Shqyrtues përmban analiza dhe vlerësime profesionale lidhur me çështjen në rastin konkret dhe se rekomandimet e tija si më sipër tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli, sepse:

Vërtetë në këtë aktivitet e prokurimit kanë ofertuar 3/tre OE nga të cilët Ankuesi është ranguar në listë i treti me radhë, në varësi të lartësisë së çmimit. Ankuesi ka pohuar se oferta e shpallur fituese nga AK, nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe se edhe oferta me numër rendor dy është papërgjegjshme sepse nuk e ka ofruar produktin sipas Standardit Evropian IEC 60601-1, me arsyetimin se produkti është kinez. Lidhur me këtë ekspert shqyrtues dhe teknik kanë shpjeguar se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar si dëshmi se prodhuesi me të cilin ka ofertuar është i certifikuar në harmoni me standardin 93/42/EEC dhe kësaj i ka bashkangjitur edhe deklaratën e konformitetit të prodhuesit në të cilën thuhet se pajisja i përgjigjet Sstandardit Evropian IEC 60601-1. Ndërsa sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me katalogun e pajisjes, eksperti shqyrtues – teknik, ka shpjeguar në vijim se OE i rekomanduar për kontratë, në ofertën e tij e ka dorëzuar katalogun në të cilin e ka bërë edhe përshkrimin detaj të pajisjes sipas specifikacionit teknik, në harmoni me dispozitat përkatëse të LPP, pa nevojë që posaçërisht të specifikohen tani ato.

Vendimi lidhur me konfiskimin e tarifës u dha në kuptim të nenit 31 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP.

- Përfundim -

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 4 paragraf 1 pika 1.36, dhe 104 paragraf 117, të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.


Kryesuese e Panelit Shqyrtues
znj. Vjosa Gradinaj-Mexhuani

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “KK – Rahovec”,

1x1 OE- N.T.SH.M “IETAMED” – Suharekë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.